



Drejtuar: Operatorit ekonomik “4 A-M” shpk
Adresa: Rruga “Musa Agolli”, Godinë 7 Katëshe, Kati 2, Ap. 18,
Tiranë

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Procedura e prokurimit: “Procedurë e Hapur” “Rikonstruksioni i infrastrukturës rrugore të bllokut të kufizuar nga rrugët Konferenca e Pezës – 3 Dëshmorët dhe rruga Ali Jegeni”

Përshkrim i shkurtër i kontratës: Qëllimi i kontratës është: “Rikonstruksioni i infrastrukturës rrugore të bllokut të kufizuar nga rrugët Konferenca e Pezës – 3 Dëshmorët dhe rruga Ali Jegeni”.

Fondi limit: 326,666,787.04 (treqind e njëzetë e gjashtë milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e shtatëqind e tetëdhjetë e shtatë pikë zero katër) lekë pa TVSH.

Burimi i financimit: vënë në dispozicion nga buxheti i Bashkisë së Tiranës për vitin 2017, miratuar me VKB Nr. 84, datë 29.12.2016, “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2017 – 2019 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2017”.

Kohëzgjatja e kontratës: 13 (trembëdhjetë) muaj kalendarike duke nisur nga dita e lidhjes së kontratës.

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: 21.04.2017, ora 11:00

Publikime të mëparshme: (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike: Buletini i Njoftimeve Publike Nr. 13 datë 03.04.2017.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojmë se, kanë qënë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Operatori ekonomik “Alba Konstruksion” shpk

NUIS J61812013R

Vlera e ofertës = **228,193,971.35** (dyqind e njëzetë e tetë milion e njëqind e nëntëdhjetë e tre mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e një pikë tridhjetë e pesë) lekë pa TVSH.

2. Bashkimi i Operatoreve ekonomik “Vëllezërit Hysa” shpk & “Beqiri” shpk

NUIS K12911201C & NUIS J98624801V

Vlera e ofertës = **236,941,612** (dyqind e tridhjetë e gjashtë milion e nëntëqind e dyzetë e një mijë e gjashtëqind e dymbëdhjetë) lekë pa TVSH.

3. Bashkimi i Operatoreve ekonomik “Bitupave LLC” Degë e shoqërisë së huaj & “Rej” shpk

NUIS L52317039A & NUIS J93711608Q

Vlera e ofertës = **244,786,054.63** (dyqind e dyzetë e katër milion e shtatëqind e tetëdhjetë e gjashtë mijë e pesëdhjetë e katër pikë gjashtëdhjetë e tre) lekë pa TVSH.

4. Operatori ekonomik “Euroteorema Peqin” shpk NUIS J61905050M

Vlera e ofertës = **250,000,000** (dyqind e pesëdhjetë milion) lekë pa TVSH.

5. Operatori ekonomik “Als Engineering Construction” shpk

NUIS L71410038G

Vlera e ofertës = **251,040,020.25** (dyqind e pesëdhjetë e një milion e dyzetë mijë e njëzetë pikë njëzetë e pesë) lekë pa TVSH.

**6. Bashkimi i Operatorëve ekonomik “2T” shpk & “Kronos Konstruksion” shpk
NUIS K01731001M & NUIS K41416033P**

Vlera e ofertës = **282,596,727.65** (dyqind e tetëdhjetë e dy milion e pesëqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e shtatëqind e njëzetë e shtatë pikë gjashtëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH.

7. Operatori ekonomik “4 A-M” shpk NUIS K92005016L

Vlera e ofertës = **303,271,057.60** (treqind e tre milion e dyqind e shtatëdhjetë e një mijë e pesëdhjetë e shtatë pikë gjashtëdhjetë) lekë pa TVSH.

**8. Bashkimi i Operatorëve ekonomik “Curri” shpk & “Xhengo” shpk
NUIS J67902718S & NUIS J64103171M**

Vlera e ofertës = **305,152,319.64** (treqind e pesë milion e njëqind e pesëdhjetë e dy mijë e treqind e nëntëmbëdhjetë pikë gjashtëdhjetë e katër) lekë pa TVSH.

9. Operatori ekonomik “Alko-Impex General Construction” Degë e shoqërisë së huaj

NUIS K91326028I

Vlera e ofertës = **309,595,402** (treqind e nëntë milion e pesëqind e nëntëdhjetë e pesë mijë e katërqind e dy) lekë pa TVSH.

10. Operatori ekonomik “Fusha” shpk NUIS J61922018S

Vlera e ofertës = **325,852,808.50** (treqind e njëzetë e pesë milion e tetëqind e pesëdhjetë e dy mijë e tetëqind e tetë pikë pesëdhjetë) lekë pa TVSH.

**Janë skualifikuar Operatorët ekonomik të mëposhtëm:
Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:**

1. Operatori ekonomik “Alba Konstruksion” shpk

NUIS J61812013R

- Për të vërtetuar përvojën e suksesshme, shoqëria “Alba Konstruksion” shpk, ka paraqitur kontratat e punës të lidhura me Fondin Shqiptar të Zhvillimi si më poshtë vijon:
 1. Kontrata e punës me objekt: “Rikonstruksion i rrugës Cerem Sektor- Tre Urat – Stravec – Gërmenj i Madh, Tre Urat – Autostrada Rrogozhinë Lushnje”, për të cilën nuk ka paraqitur Çertifikatën e marrjes në dorëzim;
 2. Kontrata e punës me objekt: “Rikonstruksioni i rrugës Rrëshen - Urake”, për të cilën nuk ka paraqitur Aktin e Kolaudimit;
 3. Kontrata e punës me objekt: “Rikualifikimi Urban të dy shesheve në qendër të Tiranës”, për të cilën nuk ka paraqitur Çertifikatën e marrjes në dorëzim.
- Për sa më lart, shoqëria “Alba Konstruksion” shpk nuk plotëson Dokumentat Standarte të Tenderit, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 1.
- Shoqëria “Alba Konstruksion” shpk nuk ka paraqitur Listpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën Shkurt 2016 – Shkurt 2017 shoqëruar me formularët e deklarimit të pagesave për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, çka bie në kundërshtim me Dokumentat Standarte të Tenderit, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 4, gërma “b”.
- Operatori ekonomik “Alba Konstruksion” shpk nuk ka paraqitur CV si dhe Librezën e punës për mjekun e përgjithshëm çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 6.
- Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, konstatoi se Operatori ekonomik “Alba Konstruksion” shpk ka deklaruar se ka të punësuar pranë shoqërisë 2 (dy) hidraulik, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 7 ku ndër të tjera përcaktohet se: *“Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar minimumi 10 (dhjetë) punonjës të pajisur me kartela personale të sigurimit teknik, të lëshuara nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial apo nga subjekte juridike private të akredituara për certifikimin e punonjësve, nga të cilët:*
 - 3 (tre) elektrikist
 - 2 (dy) saldator
 - 3 (tre) hidraulik
 - 2 (dy) teknik ndërtimi”.

- Referuar Shtojcës 9, shoqëria “Alba Konstruksion” shpk ka deklaruar se disponon 3 (tre) kamiona vetshkarkues me kapacitet mbajtës minimumi 20 ton përkatësisht me targa: TR 8023 S ; AA 281 LI dhe AA 834 KJ. Pasi verifikoi dokumentacionin shoqërues për mjetet e deklaruara si më lart, KVO konstatoi se Kamioni me targë TR 8023 S ka kapacitet mbajtës 19.9 Ton; mjeti me targë AA 281 LI ka kapacitet mbajtës 19 Ton dhe mjeti me targë AA 834 KJ ka kapacitet mbajtës 21 Ton. Për sa më lart, Operatori ekonomik disponon vetëm 1 (një) kamion vetshkarkues me kapacitet mbajtës minimumi 20 Ton, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 16, ku ndër të tjera përcaktohet se: *“Operatori ekonomik duhet të disponojë 3 (tre) kamiona vetshkarkues minimum 20 Ton”*.
- Shoqëria “Alba Konstruksion” shpk ka deklaruar se disponon 4 (katër) kamionçina përkatësisht me targa TR 7203 J; AA 185; TR 3038 L si dhe AA536 LP. Pasi verifikoi dokumentacionin shoqërues për mjetet e deklaruara si më lart, KVO konstatoi se Kamionçina me targë TR 7203 J ka kapacitet mbajtës 0.8 Ton; mjeti me targë TR 3038 L ka kapacitet mbajtës 2.5 Ton; mjeti me targë AA 536 LP ka kapacitet mbajtës 1.3 Ton. Për mejetin me targë AA 185, Operatori ekonomik nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion që të provojë disponueshmërinë e tij. Për sa më lart, Operatori ekonomik “Alba Konstruksion” shpk nuk plotëson Dokumentat Standarte të Tenderit , Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 16, ku ndër të tjera përcaktohet se: *“Operatori ekonomik duhet të disponojë 2 (dy) kamiona vetshkarkues me kapacitet mbajtës 3.5 – 5 ton”*.
- Referuar Shtojcës 9, Operatori ekonomik “Alba Konstruksion” shpk ka deklaruar se disponon 2 (dy) Autobot Uji përkatësisht me targa TR 7926 S si dhe AA 823 MP. KVO, pasi verifikoi dokumentacionin shoqërues për mjetet e deklaruara si më lart, konstatoi se mjeti me targë TR 7926 S rezulton të jetë Autobot uji i montuar = Kamion me targa TR 7926 S + depozitë uji, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 16 ku është kërkuar që *“Operatorët ekonomik pjesmarrës duhet të disponojnë Autobot Uji 2 (dy) copë”*.
- Referuar Faturave Tatimore të Blerjes, rezulton se shoqëria “Alba Konstruksion” shpk disponon 50 (pesëdhjetë) kokore, çka çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 16 ku ndër të tjera përcaktohet se: *“Operatori ekonomik pjesmarrës duhet të disponojë 100 (njëqind) kokore”*.
- KVO konstatoi se Operatori ekonomik “Alba Konstruksion” shpk nuk ka paraqitur foto për çdo mjet të deklaruar sipas Shtojcës 9 e konkretisht për mjetet: Grejder; Rrul Vibrues si dhe Makineri vijëzimi me bojë bikomponente, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 16, gërma “d”.
- Sa më lart, në mbështetje të Nenit 46, pika 1, gërma “b” të Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe referuar Kreut III, Seksioni II, Neni 26, pika 8, gërma “c” të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), të cilat parashikojnë kualifikimin për aftësinë teknike të kandidatëve ofertues, Operatori ekonomik “Alba Konstruksion” shpk, referuar Shtojcës 9 si edhe dokumentacionit shoqërues për mjetet e paraqitura, nuk ka aftësinë e duhur teknike për realizimin me sukses të kontratës.

- Gjithashtu, Operatori ekonomik “Alba Konstruksion” shpk nuk ka paraqitur Grafikun e Punimeve, çka bie në kundërshtim me DST, Shtojca 12 ku përcaktohet se: *“Operatori ekonomik duhet të paraqesë grafikun e punimeve të detajuar sipas zërave të preventivit të hedhur në tender të shprehur në afatin kohor të përcaktuar në dokumentat e tenderit për 13 (trembëdhjetë) muaj kalendarike.”*

2. Bashkimi i Operatoreve ekonomik “Vëllezërit Hysa” shpk & “Beqiri” shpk

NUIS K12911201C & NUIS J98624801V

- **Shoqëria “Vëllezërit Hysa” shpk** nuk plotëson pikën 1 të kapacitetit Teknik: “Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën: a. Punë të ngjashme për një objekt të vetëm me vlerë 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe konkretisht: 163,333,394 (njëqind e gjashtëdhjetë e tre milion e treqind e tridhjetë e tre mijë e treqind e nëntëdhjetë e katër) lekë pa TVSH, të realizuar gjatë tri viteve të fundit. b.punë të ngjashme deri ne nje kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë tre viteve të fundit është në një vlerë sa dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet dhe konkretisht: 653,333,574 (gjashtëqind e pesëdhjetë e tre milion e treqind e tridhjetë e tre mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e katër) lekë pa TVSH. Plotesimi i njerit prej dy kushteve te siperpermendura e ben oferten te kualifikueshme. Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtmePër kontrata të realizuara me ente publike,operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm: 1. Deklaratën sipas shtojcës Nr. 8, shoqëruar me: 2.Kontratë. 3. Situacionin përfundimtar; 4. Aktin e kolaudimit; 5. Çertifikaten e marrjes ne dorezim”, **pasi për punën e ngjashme, kontrata me objekt “ Riveshje dhe Sistemim Asfaltim Rruga Elbasan-Banjë, Loti 1”, nr. 3869/5, datë 04.08.2015 nuk ka paraqitur Certifikaten e marrjes ne dorezim.**
- **Shoqëria “Beqiri” shpk** nuk plotëson pikën 7 të kapacitetit Teknik: “Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar minimumi 10 (dhjetë) punonjës të pajisur me kartela personale të sigurimit teknik, të lëshuara nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial apo nga subjekte juridike private të akredituara për certifikimin e punonjësve, nga të cilët: 3 (tre) elektrikist, 2 (dy) saldator, 3 (tre) hidraulik, 2 (dy) teknik ndërtimiPër punonjësit e mësipërm duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme; deshmite e kualifikimit te sigurimit teknik, si dhe te figurojne ne listpagesat e shoqërisë për të paktën 6 (gjashtë) muajt e fundit” **pasi për saldatorin Bashkim Duraj nuk ka paraqitur kartelë personale të sigurimit teknik, të lëshuara nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial apo nga subjekte juridike private të akredituara për certifikimin e punonjësve.**
- **Shoqëria “Beqiri” shpk** nuk plotëson pikën 16.d të kapacitetit Teknik: “Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit” **pasi për fadromat me goma, me targa përkatësisht AA318BX dhe ABMT67, të marra me qera, nuk ka paraqitur foto.**
- **Bashkimi i Operatoreve ekonomikë “Vëllezërit Hysa” shpk & “Beqiri” shpk** nuk plotëson pikën 16 të kapacitetit Teknik: “Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutim in e kontratë (Shtojca 9)/ Eskavator me goma-2 copë” **opetratori ekonomik “Vëllezërit Hysa” shpk në shtojcën 9 nuk ka deklaruar asnjë eskavator me goma**

ndërsa operatori ekonomik “Beqiri” shpk ka deklaruar vetëm 1 (një) eskavator me goma me targë AAMT18, nga 2 (dy) të kërkuar.

- **Bashkimi i Operatorëve ekonomikë “Vëllezërit Hysa” shpk & “Beqiri” shpk nuk plotëson pikën 16 të kapacitetit Teknik: “Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutim in e kontratë (Shtojca 9)/Autobitumatrice”, pasi nga verifikimi i dokumentacioni, mjeti me targa AA230HV i deklaruar nga operatori “Beqiri” shpk si Autobitumatrice, rezulton të jetë Kamion.**

3. Bashkimi i Operatoreve ekonomik “Bitupave LLC” Degë e shoqërisë së huaj & “Rej” shpk

NUIS L52317039A & NUIS J93711608Q

- Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstatoi se shoqëria “Rej” shpk nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion për Drejtuesin Teknik të punimeve të deklaruar për procedurën e prokurimit me objekt: *“Rikonstruksioni i infrastrukturës rrugore të bllokut të kufizuar nga rrugët Konferenca e Pezës – 3 Dëshmorët dhe rruga Ali Jegeni”*, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 3.
- Bashkimi i Operatorëve ekonomik “Bitupave LLC” Degë e shoqërisë së huaj & “Rej” shpk ka deklaruar se disponon 7 (shtatë) punonjës elektrikist; 3 (tre) punonjës saldator si dhe 7 (shtatë) punonjës hidraulik. Referuar përqindjes së pjesmarrjes në punë të përcaktuar në Kontratën e Partneritetit (Join-Venture) me Nr. 653 Rep. , Nr. 137/1 Kol. datë 20.04.2017, rezulton se punonjësit e deklaruar nga shoqëria “Bitupave LLC” Degë e shoqërisë së huaj nuk figurojnë në listpagesat e shoqërisë për të paktën 6 (gjasthtë) muajt e fundit, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 7.
- Bashkimi i Operatorëve ekonomik “Bitupave LLC” Degë e shoqërisë së huaj & “Rej” shpk ka deklaruar se disponon 1 (një) punonjës teknik ndërtim, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 7 ku ndër të tjera përcaktohet se: *“Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar minimumi 10 (dhjetë) punonjës të pajisur me kartela personale të sigurimit teknik, të lëshuara nga Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial apo nga subjekte juridike private të akredituara për certifikimin e punonjësve, nga të cilët:*
 - 3 (tre) elektrikist
 - 2 (dy) saldator
 - 3 (tre) hidraulik
 - 2 (dy) teknik ndërtimi”.
- Bashkimi i Operatorëve ekonomik “Bitupave LLC” Degë e shoqërisë së huaj & “Rej” shpk ka deklaruar se disponon 17 (shtatëmbëdhjetë) punonjës manovrator. Referuar përqindjes së pjesmarrjes në punë të përcaktuar në Kontratën e Partneritetit (Join-Venture) me Nr. 653 Rep. , Nr. 137/1 Kol. datë 20.04.2017, rezulton se punonjësit e

deklaruar nga shoqëria “Bitupave LLC” Degë e shoqërisë së huaj nuk figuron në listpagesat e shoqërisë për të paktën 6 (gjashtë) muajt e fundit, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 8.

- Për sa më lart, Bashkimi i Operatorëve ekonomik nuk zotëron kapacitet te mjaftueshem teknik per sa i perket personelit te nevojshem per te realizuar kontraten per kete objekt prokurimi, çka bie në kundërshtim me pikën 1 gërma (b) të Nenit 46 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe me VKM-në Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Kreu VIII, Neni 74, pika 3 ku nder te tjera percaktohet se: “.....*kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje....”.*
- Shoqëria “Bitupave LLC” Degë e shoqërisë së huaj nuk ka paraqitur Deklaratë mbi mosangazhimin e mjeteve të Deklaruara sipas Shtojcës 9, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 16, gërma “f”.

4. Operatori ekonomik “Euroteorema Peqin” shpk NUIS J61905050M

- Operatori ekonomik “Euroteorema Peqin” shpk nuk plotëson pikën 14 të kapacitetit Teknik: “Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatë ISO 27001 - 2013 (e vlefshme). (Në rastin e Bashkimit të Operatorëve ekonomik çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë certifikatën e mësipërme)” **pasi nuk ka paraqitur Certifikatën ISO 27001 - 2013.**
- Operatori ekonomik “Euroteorema Peqin” shpk nuk plotëson pikën 16 të kapacitetit Teknik: “Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutim in e kontratë (Shtojca 9)/ Autobitumatrice” **pasi në shtojcën 9 ka deklaruar mjetin “kamion për autobitumatrice” me targë AA7230LO dhe nga verifikimi i dokumentacionit rezulton nje mjet i montuar, kamion+bitumatrice.**
- Operatori ekonomik “Euroteorema Peqin” shpk nuk plotëson pikën 16 të kapacitetit Teknik: “Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutim in e kontratë (Shtojca 9) ” **pasi në shtojcën 9 ka deklaruar Kamion 3.5-5 ton, me targë AA440LI por nga verifikimi i dokumentacionit rezulton kamion me kapacitet 0.9 ton.**
- Operatori ekonomik “Euroteorema Peqin” shpk nuk plotëson pikën 16 të kapacitetit Teknik: “Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutim in e kontratë (Shtojca 9) ” **pasi në shtojcën 9 ka deklaruar Kamion 3.5-5 ton, me targë AA445LI por nga verifikimi i dokumentacionit rezulton kamion me kapacitet 1.35 ton.**

5. Operatori ekonomik “Als Engineering Construction” shpk

NUIS L71410038G

- Pas hapjes së ofertave, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstatoi se Operatori ekonomik “Als Engineering Construction” shpk ka paraqitur në sistemin elektronik Ekstraktin mbi historikun e subjektit si dhe Shtojcën 1. Ky fakt i konstatuar nga KVO-ja u regjistrua në procesverbalin e vlerësimit të ofertave.
- Mungesa e dokumentacionit të plotë ligjor, ekonomik dhe teknik u konfirmua nga të gjithë anëtarët e KVO-së në tërësi dhe Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të Nenit 53, pika 3 dhe pika 5, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin publik”, (i ndryshuar) dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Kreu VII Neni 66 pika 3, e shpall **të pavlefshme** këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

6. Bashkimi i Operatorëve ekonomik “2T” shpk & “Kronos Konstruksion” shpk NUIS K01731001M & NUIS K41416033P

- **Shoqëria “2T” shpk** në kundërshtim me detyrimin e pikës 2.8.1 të Dokumentave Standarte të Tenderit, e cila specifikon se për procedurën e prokurimit me objekt: “Rikonstruksioni i infrastrukturës rrugore të bllokut të kufizuar nga rrugët Konferenca e Pezës-3 Dëshmorët dhe rruga Ali Jegeni”, nuk lejohet nënkontraktimi, me anë të një deklarate nënkontraktimi ka deklaruar se do të nënkontraktojë 40% të zërave të punimeve të përvetësit.
- **Shoqëria “2T” shpk** nuk plotëson pikën 1 të kapacitetit Teknik: “Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën: a. Punë të ngjashme për një objekt të vetëm me vlerë 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe konkretisht: 163,333,394 (njëqind e gjashtëdhjetë e tre milion e treqind e tridhjetë e tre mijë e treqind e nëntëdhjetë e katër) lekë pa TVSH, të realizuar gjatë tri viteve të fundit. b.punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë tre viteve të fundit është në një vlerë sa dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet dhe konkretisht: 653,333,574 (gjashtëqind e pesëdhjetë e tre milion e treqind e tridhjetë e tre mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e katër) lekë pa TVSH. Plotesimi i njerit prej dy kushteve të sipërpermendura e ben oferten të kualifikueshme. Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme Për kontrata të realizuara me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm: 1. Deklaratën sipas shtojcës Nr. 8, shoqëruar me: 2.Kontratë. 3. Situacionin përfundimtar; 4. Aktin e kolaudimit; 5. Çertifikatën e marrjes në dorezim”, **pasi për punën e ngjashme, kontrata me objekt “Punime për ndërtimin e By-Pass të Rrogozhinës, EuropeAid/134340/C/ËKS/AL”, nr. 2013/332-864, nuk ka paraqitur Aktin e kolaudimit.**
- **Shoqëria “2T” shpk** nuk plotëson pikën 16 të kapacitetit Teknik: “Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutim in e kontratë (Shtojca 9)/Autobitumatrice”, **pasi në shtojcën 9 ka deklaruar si Autobitumatrice të marrë me qera, mjetin me targë AA155NY por nga verifikimi i dokumentacionit dhe fotos së paraqitur ky mjet rezulton të jetë ATP-Kamioncinë, i certifikuar për transport mallrash brenda vendit për llogari të vet.**
- **Bashkimi i Operatorëve ekonomikë “2T” shpk & “Kronos Konstruksion” shpk** nuk plotëson pikën 16 të kapacitetit Teknik: “Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që

ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutim in e kontratë (Shtojca 9)/ Kamion vetëshkarkues 3.5 ton - 5 ton”, **pasi në shtojcën 9 kanë deklaruar si Kamioncinë, mjetin me targë AA731CN i cili ka një kapacitet 1.2 ton.Gjithashtu nga verifikimi i dokumentacionit të mjeteve të deklaruar Kamionë në Shtojcën 9 nga secili operator i bashkimit ekonomik rezulton se vetëm 1 (një) kamion vetëshkarkues plotëson kriterin 3.5-5 ton, nga 2 (dy) të kërkuar.**

7. Bashkimi i Operatorëve ekonomik “Curri” shpk & “Xhengo” shpk NUIS J67902718S & NUIS J64103171M

- Për të vërtetuar përvojën e suksesshme, shoqëria “Curri” shpk, ka paraqitur kontratat e punës si më poshtë vijon:

1. Kontrata e punës me objekt: “Rikualifikimi Urban Pista Aeroportuale”, për të cilën nuk ka paraqitur Çertifikatën e marrjes në dorëzim si dhe Formularin e Vlerësimit sipas Shtojcës 8;
2. Kontrata e punës me objekt: “Rikonstruksioni i rrugës Porcelan-Kionostudio-Surrel”, për të cilën nuk ka paraqitur Çertifikatën e marrjes në dorëzim;
3. Kontrata e punës me objekt: “Plotësimi i segmentit Dragobi-Valbonë”, për të cilën nuk ka paraqitur Çertifikatën e marrjes në dorëzim.

Ndërsa shoqëria “Xhengo” shpk, për të vërtetuar përvojën e suksesshme, ka paraqitur kontratën e punës si më poshtë vijon:

1. Kontrata e punës me objekt: “Rikonstruksion i rrugës Gjon Buzuku, Sheshi i Poliklinikës, Sheshi i Xhamisë, Sheshi i Pazarit, Rruga e Mborjes, Rruga e Ravonikut”, për të cilën nuk ka paraqitur Çertifikatën e marrjes në dorëzim.

Për sa më lart, Bashkimi i Operatorëve ekonomik “Curri” shpk & “Xhengo” shpk nuk plotëson Dokumentat Standarte të Tenderit, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 1.

- Shoqëria “Curri” shpk nuk ka paraqitur CV si dhe Librezën e punës për mjekun e përgjithshëm të deklaruar, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 6.
- Shoqëria “Xhengo” shpk nuk ka paraqitur CV, Librezën e punës si dhe Urdhërin e Mjekut për mjekun e përgjithshëm të deklaruar, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 6.
- Shoqëria “Xhengo” shpk nuk ka paraqitur Çertifikatën ISO 27001 – 2013 (të vlefshme), çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 14.
- Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstatoi se mjeti Autobitumatriçe e deklaruar në Shtojcën 9, nuk është e shoqëruar me dokumentacionin e kërkuar: Leje qarkullimi, Çertifikatën e kontrollit teknik si dhe siguracionin e mjetit, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 16, gërma “a”.
- Bashkimi i Operatorëve ekonomik “Curri” shpk & “Xhengo” shpk nuk ka paraqitur foto për çdo mjet të deklaruar sipas Shtojcës 9, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 16, gërma “d”.

- Sa më lart, në mbështetje të Nenit 46, pika 1, gërma “b” të Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe referuar Kreut III, Seksioni II, Neni 26, pika 8, gërma “c” të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), të cilat parashikojnë kualifikimin për **aftësinë teknike** të kandidatëve ofertues, Bashkimi i Operatorëve ekonomik “Curri” shpk & “Xhengo” shpk, referuar Shtojcës 9 si edhe dokumentacionit shoqërues për mjetet e paraqitura, nuk ka aftësinë e duhur teknike për realizimin me sukses të kontratës.

8. Operatori ekonomik “Alko-Impex General Construction” Degë e shoqërisë së huaj **NUIS K91326028I**

- Referuar Shtojcës 9, Operatori ekonomik “Alko-Impex General Construction” Degë e shoqërisë së huaj ka deklaruar se disponon 11 (njëmbëdhjetë) Kamiona vetshkarkues. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pasi verifikoi dokumentacionin shoqërues për çdo mjet të deklaruar konstatoi se asnjë nga Kamionat vetshkarkues nuk ka kapacitet mbajtës minimum 20 Ton, çka bie në kundërshtim me Dokumentat Standarte të Tenderit, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 16, ku ndër të tjera përcaktohet se: *“Operatori ekonomik duhet të disponojë 3 (tre) kamiona vetshkarkues me kapacitet mbajtës minimum 20 Ton”*.
- Referuar Shtojcës 9, Operatori ekonomik “Alko-Impex General Construction” Degë e shoqërisë së huaj ka deklaruar se disponon 2 (dy) Autobetoniere përkatësisht me targa 01-166-CM dhe 01-347-HI. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, pasi verifikoi dokumentacionin shoqërues për mjetet e deklaruara si më lart, konstatoi se mjeti me targa 01-347-HI rezulton të jetë Kamion dhe jo Autobetoniere. Për sa më lart në mbështetje të Shtojcës 9, shoqëria “Alko-Impex General Construction” Degë e shoqërisë së huaj disponon vetëm 1 (një) Autobetoniere, çka bie në kundërshtim me Dokumentat Standarte të Tenderit, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 16, ku ndër të tjera përcaktohet se: *“Operatori ekonomik duhet të disponojë 2 (dy) Autobetoniere”*.
- Operatori ekonomik “Alko-Impex General Construction” Degë e shoqërisë së huaj nuk ka paraqitur foto për çdo mjet të deklaruar sipas Shtojcës 9 e konkretisht për Kamionin vetshkarkues me targa 01-835XB dhe për Autobetonieret e deklaruara, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 16, gërma “d”.
- Sa më lart, në mbështetje të Nenit 46, pika 1, gërma “b” të Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe referuar Kreut III, Seksioni II, Neni 26, pika 8, gërma “c” të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), të cilat parashikojnë kualifikimin për **aftësinë teknike** të kandidatëve ofertues, Operatori ekonomik “Alko-Impex General Construction” Degë e shoqërisë së huaj, referuar Shtojcës 9 si edhe dokumentacionit shoqërues për mjetet e paraqitura, nuk ka aftësinë e duhur teknike për realizimin me sukses të kontratës.

9. Operatori ekonomik “Fusha” shpk **NUIS J61922018S**

- Operatori ekonomik “Fusha” shpk nuk plotëson pikën 16 të kapacitetit Teknik: “Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutim in e kontratë (Shtojca 9)/ Kamion vetëshkarkues 3.5 ton - 5 ton ” **pasi asnjë nga kamioncinat e deklaruar në shtojcën 9, përkatësisht me targa AA178LM, TR8265T, AA154GO dhe AA891CU nuk përmbush kapacitetin e kërkuar 3.5-5 ton.**
- Operatori ekonomik “Fusha” shpk nuk plotëson pikën 16.d të kapacitetit Teknik: “Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit” **pasi për mjetet me targa të deklaruara në Shtojcën 9, nuk ka paraqitur foto.**
- Operatori ekonomik “Fusha” shpk nuk plotëson pikën 16 të kapacitetit Teknik: “Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutim in e kontratë (Shtojca 9)/Autobitumatrice”, **pasi në shtojcën 9 ka deklaruar Autobitumatrice me faturë Doganore dhe nuk ka paraqitur dokumentacionin përkatës.**

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **Operatorin ekonomik “4 A-M” shpk**, me adresë: **Rruga “Musa Agolli”, Godinë 7 Katëshe, Kati 2, Ap. 18, Tiranë**, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej **303,271,057.60** (treqind e tre milion e dyqind e shtatëdhjetë e një mijë e pesëdhjetë e shtatë pikë gjashtëdhjetë) lekë pa TVSH, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Bashkisë së Tiranës, Shëtitorja “Dëshmorët e Kombit”, Nr. 1, 1001, Tiranë, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes së këtij njoftimi.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë: 05.05.2017

Gjatë afatit ligjor për pritjen e ankesave nga shoqëritë pjesëmarrëse në tender në mbështetje të Nenit 63 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe në bazë të Kreut X, Neni 78 të VKM-së Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), pranë Autoritetit Kontraktor, Bashkia Tiranë, nuk është paraqitur asnjë ankesë.